



RELACION TEKNIK

“**NDERTIM DHE RIKONSTRUKSION GODINE PER MBARESHTIMIN E KAFSHEVE**” **FSHATI FRASHER, FIER**

Pergatiti: Msc. Ing. Mjedisi Denisa KOLA

A handwritten signature in blue ink, appearing to be 'Denisa Kola', is written above the name of the preparer.



TIRANE 2016

HYRJE

Raporti synon te jape nje informacion te detajuar dhe te besueshem lidhur me ndikimin mjedisor te projektit te propozuar ne perdorimin e tokes, efektet lidhur me ndikimet ne floren, faunen, burimet e ujit, emetimin e gazeve sere ne atmosfere, shkarkimet ne toke, uje, ndotjen akustike, si dhe çdo ndikim social ekonomik ne punesimin lokal, permiresimin e infrastructures dhe ndikimeve te tjera te rendesishme mjedisore ose sociale, perfshin gjithashtu parashikimin dhe planifikimin e masave zbutese te ndikimeve te projektit ne mjedisin fizik dhe social me qellim permisimin e cilesise dhe qendrushmerise se mjedisit nepermjet :

- Marrjes ne konsiderate te çeshtjeve te mjedisit ne fazen e pergatitjes se projektit.
- Shqyrtimit te alternativave te ndryshme brenda projektit.
- Te jape nje gjendje sa me reale, nga pikepamja e ndikimit te aktivitetit mbi mjedisin human.
- Analizen e faktoreve pozitive e negative mjedisore, percaktimin e masave zbutese per reduktimin e ndikimeve negative.
- Nxjerrjes ne dukje dhe vlersimin cilesor te ndikimeve ne mjedis te projektit.
- Propozime te masave zbutese te ndikimit ne projekt.

Mjedisi dhe mbrojtja e tij nuk eshte i rendesishem vetem per njerezit por eshte thelbesor dhe i nevojshem per te gjitha qeniet ne toke. Njerezit duhet te kuptojne se si perdorimi i burimeve mjedisore dhe perfitimet qe vijne nga ato te mos demtohen por te jete e mundur te perfitohet sot dhe ne te ardhmen. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qe eshte bere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajuara , emetimet e gazeve te demshem ne atmosfere , perdorimi i kimikateve te reja pa marre parasysh demet qe mund ti sjellin mjedisit kane sjelle problemet mjedisore me te cilat ne perballemi ne ditet e sotme. Ndaj eshte e nevojshme qe shoqeria te ndergjegjesohet per ta mbajtur sa me paster mjedisin ku jetojme duke marre masat e duhura per trajtimin e mbetjeve si dhe emetimin e gazeve te demshem ne atmosfere qe gjenerohen nga zhvillimi i aktiviteteve te ndryshme. Ne menyre qe te shmangen keto probleme njerezimi duhet te mesoj se si te menaxhohen burimet natyrore ne menyre te qendrueshme. Pra zhvillimi i qendrueshem i burimeve natyrore nuk eshte gje tjeter vecse perdorimi i tyre ne menyre ekonomike nga brezat e sotem per ti len keto burime te perdoren edhe nga brezat qe do te vijne. Qendrueshmeria perfshin menaxhimin e gjithe perberesve dhe burimeve natyrore e njerezore me qellim qe te pasurohen me kalimin e kohes dhe te sigurohet nje mireqenie per te gjitha. Zhvillimi i qendrueshem nuk i pranon politikat te cilat cojne ne uljen e bazes prodhuese dhe lene gjeneratat e ardhshme me prespektiva me te ulta (te varfera) dhe/ose rreziqe me te medha se te tonat. Teknologjite qe kontribuojne ne zhvillimin e qendrueshem perfshijne kontrollin e ndotjes, prodhimin e energjise se riciklueshme, rikuperim burimesh dhe riciklim, menaxhim burimesh dhe kerkime shkencore.

Vitet e fundit industria e ndertimit ne vendin tone ka patur nje zhvillim te madh. Kompanite e ndertimit ne vendin tone jane nder subjektet e biznesit me me teper fitim dhe qe zhvillojne nje aktivitet te madh ekonomik. Vet sektori i ndertimit ne vendin tone eshte nje nga shtyllat e ekonomise shqiptare dhe numeron nje numer te konsiderueshm te punesuarish, ne nje kohe qe kompanite e ndertimit sot jane nder taksa-paguesit me te medhenj te arkes se shtetit. Aktiviteti te cilin ne do te trajtojme eshte "Ndertim dhe rikonstruksion godine per mbareshtimin e kafsheve".

Pra impakti mjedisor i referohet ndryshimit te mjedisit natyror nga aktiviteti njerezor.

Kemi dy tipe te impaktit mjedisor:

- Shterimi i burimeve
- Ndotja

Ne menyre qe te shmangen keto probleme njerezimi duhet te mesoj se si te menaxhohen burimet natyrore ne menyre te qendrueshme.

a) Qellimi i Projektit

Qellimi i ketij aktiviteti eshte Vleresimin e pergjithshem, te integruar dhe ne kohe te ndikimeve mjedisore, te projekteve qe do te zbatohen duke parandaluar dhe zbutur ndikimet negative ne mjedis me qellim mbrojtjen e mjedisit nga ndotja. Te gjitha proceset e punes qe nga sigurimi i lendeve te para e deri ne perfundim do te zbatohen konform akteve ligjore ne fuqi per mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qendrueshem te tij.

b) Planimetria e vendodhjes se projektit , ku te pasqyrohen ne harten topografike siperfaqja e tokes se kerkuar , kufijt e siperfaqes se kerkuar , te dhenat per perdorimin ekzistues te siperfaqes se tokes qe do te perdoret perkohesisht apo perhere nga projekti gjate fazes se ndertimit apo instalimit te pajisjeve.

Prona ne te cilen do te ushtohet aktiviteti "Ndertim dhe rikonstruksion godine per mbareshtimin e kafsheve" ndodhet ne fshatin Frasher, Bashkia Patos, Qarku Fier.



Pamje nga Google Earth

Tabela Nr. 1 Koordinatat e zones sipas sistemit GAUS GRUGE

E	N
4384009.06	4510666.89

c) Gjeografia e topografia e zones

Rrethi i Fierit shtrihet ne pjesen jug-perernfanore te territorit te Qarkut Fier, kufizohet ne veri nga rrethi i Lushnjes, ne lindje nga rrethi i Beratit, jug-Undje nga Mallakastra dhe ne jug nga rrethi i Vlôres. Sipmfaqja e rrethit Fier eshte: 152.65 km² ndersa Popullsia e rrethit Fier eshte rreth: 263.701 banore. FRASHERI përfshihet ne zonën klimatike mesdhetare fushore të Shqipërisë. Klima e kësaj zone karakterizohet nga dimer i bute dhe i laget dhe vere të nxehte dhe të thate. Vendmatjet bazë që kanë shërbyer për studimin e veçorive klimatike të zonës janë Fieri dhe Vlora.



- d) **Pershkrim i procesit ndertimore dhe teknologjike, perfshire kapacitetet prodhuese perpunuese , sasite e lendeve te para dhe produktet perfundimtare te projektit**

•Pershkrimi i procesit ndertimor dhe teknologjike

Projektit “Ndertim dhe rikonstrukcion godine per mbareshtimin e kafsheve” konsiston ne shtimin e siperfaqes se godines per mbareshtimin e kafsheve ne fshatin Frasher, Qarku Fier ne te majte te rruges Fier-Rroskovec, rreth 3-4 km larg ketij aksi. Siperfaqja ne te cilen do te nderhyet eshte rreth 6604 m².

Projekti “Ndertim dhe rikonstrukcion godine per mbareshtimin e kafsheve” parashikon nderhyrje permiresuese ne lidhje me problematikat e hasura, shtimin e funksioneve aktuale , ruajtjen dhe permiresimin e pejsazhit. Projektimi ka mbajtur ne konsiderate dhe aktivitetet e ndryshme social-kulturore.

Me poshte pasqyrohen siperfaqet perkatese dhe pershkruhen me shifra elementet e projektuar te ketij kapanoni:

Siperfaqja qe zhvillohet 6604 m²

Siperfaqja e pergjithshme e ndertimit mbi toke 658 m²

Lloj i mbuleses - me sanduic metalik

Ne zonen ku do te zhvillohet ky projekt nuk ka shtepi banimi,shkolla,dhe aktivitete te tjera social kulturore, qe mund te demtohen nga zhvillimi i ketij projekti nga subjekti. Objekti do

te ndertohet ne nje siperfaqe te sheshte,ne kuoten e rruges. Ky studim percakton nje menyre zhvillimi te kesaj zone duke percaktuar disa kriterere parimore mbi zonen ,menyren e ndertimit , koeficientin e shfrytezimit te truallit, ushtrimin e projektit etj. Subjekti ka per qellim ushtrimin e projektit “Ndertim godine, kapanon” E rendesishme eshte te theksojme se rrethimi i ambjentit,ku do te ndertohet kapanoni industrial nga ky subjekt ka sjelle nje impakt estetik pozitiv ne krahasim me gjendjen e meparshme, duke kontribuar e ndikuar ne zhvillim racional dhe pozitiv te kesaj zone. Investitori privat ka kryer te gjitha studimet perkatese dhe ka bere studimin e infrastruktures inxhinjerike,si dhe studimin e qendrueshmerise se tokes, para se te filloje nga puna,ndertimi i. “Ndertim dhe rikonstruksion godine per mbareshtimin e kafsheve”.



Foto nga vendi ku do te behet shtesa e projektit

-Sasite e lendeve te para dhe produktet perfundimtare te projektit**- Sasite e lendeve te para**

Lenedet e para qe do te perdoren jane gure gelqerore , beton dhe blloka per ndertimin e mureve rrethuese te kapanonit kurse pjesa e sipërme pra mbulesa do te behet me panele sanduic.

Lendet ndihmesie per kete veper jane:

-Energji elektrike qe sigurohet nga rrjeti elektrik i zones

- uje qe do te sigurohet nga nje pus te cilin subjekti do ta hapi ne ambjentet e punes ku do te ndertohet dhe shtesa

- e) **Infrastruktura e nevojshme per lidhjen me rrjetin elektrike, furnizimin me uje, shkarkimet e ujerave te ndotura dhe mbetjeve si dhe informacion per rruget ekzistuese te aksesit apo nevojen per hapje te rrugeve te reja**

Infrastruktura e nevojshme per lidhjen me rrjetin elektrik**Furnizimi me uje**

Furnizimi me uje realizohet nga burimet e nentokesore pra sic e kemi permendur edhe me siper kompania do te hapi nje pus ne ambjentet e punes te cilin do e perdorin edhe me vone.

Furnizimi me energjia

Edhe energjia eshte nje aspekt i dobet i kesaj zone. Burimi kryesor i energjise eshte ajo elektrike. Per furnizimin e subjektit me energji ai do te kidhi kontrate me OSSH nga rrjeti ekzistues i zones.

- f) **Programi per ndertimin, kohezgjatjen e ndertimit, kohezgjatja e planifikuar e funksionimit te projektit, kohen e mundeshme te perfundimit te funksionimit te projektit dhe faza e planifikuar per rehabilitimin e siperfaqes pas mbarimit te funksionimit te projektit**

Programi i punes

Per zhvillimin e projektit eshte kaluar ne disa faza

- Fillimisht eshte vendosur zona ne te cilet do behet nderhyrja pra ndertimi e projektit e cila eshte toke are ne pronesi te subjektit Mikail Priftit.

- Piketimi i nderteses (ne kuota absolute) .

g) Menyrat dhe metodat qe do te perdoren per ndertimi

- 1-Ndertimi do te filloj me piketimin e zones dhe relievit te saj.
- 2-Fiksimi i pikave ne ku te behen hapjet e plintave me faza, pozicioni i te calave saktosohet me metoden e prerjes mes dy instrumentave.
- 3-Furnizimi me energji elektrike i objektit do te behet me nje lidhje te re nga linja ekzistuese tre fazore qe kalon ne trasen e rruges dhe pershkron persegjati gjith pjesen veriore te objektit.

h) lendet e para qe do te perdoren per ndertimin dhe menyra e sigurimit te tyre (materiale ndertimi, uje dhe energji)

Lendet e para ndihmese qe do te perdoren jane:

- Naftë dhe Vajra lubrifikant për makinerite që do të transportojnë dhe do të hedhin në uje lenden e pare pragurin gelqeror.
- Kamiona vetshkarkues, buldozera dhe grejfer që do të shërbejnë për vendosjen e gureve të mbedhenj në ekstremitetet e vepres.
- Cakell për të beret e mundur shtrimin e sheshit

j)Informacion lidhur me alternativat e marra ne considerate persa i takon perzgjedhjes se vendodhjes se projektit dhe teknologjise qe do perdoret

Perzgjedhja e kesaj zone ka ardhur si rrjedhoje e e pronesise se tokes ne emer te subjektit MIKAIL PRIFTI.

k) Perdorimin e lendeve te para gjate funksionimit, perfshire sasite e ujit te nevojshme , energjise, lendeve djegese dhe menyren e sigurimit te tyre

Ky aktivitet gjate funksionimit te tij nuk do te perdore lende te pare.

l)Aktivitete te tjera qe mund te nevojiten per zbatimin e projektit , si ndertim i kampeve apo rezidencave etj.

Zhvillimi i projektit nuk kerkon ndertimin e kampeve per qendrimin e punetoreve gjate kohes se ndertimit sepse numri i te punesuarve nuk eshte aq i madh sa per te ndertuar keto kampe per fjetje apo mensa sherbimi. Teknologjia e perdorur per ndertim do te jete me blloqe betoni dhe llac ndersa posht do te shtrohet me beton dhe pjesa e sipërme do të mbulohet me panele sanduic.

m) Informacion per lejet dhe licensat e nevojshme per projektin te kerkuara nga legjislacioni ne fuqi si dhe institucionet kompetente per lejimin/licensimin e projektit

Ne baze te Vendimit Nr.686, date 29.07.2015 “Per miratimin e rregullave, te pergjithesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis (VNM)dhe procedures se transferimit te vendimit e deklarates mjedisore” subjekti MIKAIL PRIFTI sh.p.k ka pergatitur dokumentat per tu paisur me leje mjedisore (VNM Paraprake) si ne rastin tone.

